



Komuna e Klinës

Kryetari i Komunës

01Nr. 112-431 /2023

Klinë, datë 04.01.2023

Duke u bazuar në nenin 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, nr.03/L-040, botuar në Gazetën Zyrtare, nr.28/2008 të publikuar me dt.04.06.2008, dispozitat e nenit 33 të Ligjit për Zyrtaret Publik, nr.06/L-114, nenin 91 paragrafi 1 të Statutit të Komunës së Klinës të dt. 07.04.2010, dispozitat e nenit 22, 23 dhe 24 të Rregullores së (QRK) nr.10/2022 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, si dhe duke marrë shkresën njoftuese të Ministrisë së Punëve të Brendshme, nr.1959 të datës 14.12.2022, Kryetari i Komunës së Klinës, **merr këtë;**

V E N D I M

*Për formimin e grupit punues për vlerësim e klasifikimit të vendeve të punës në shërbimin civil
Komuna e Klinës*

- FORMOHET**, grupi i vlerësimit për klasifikimin e vendeve të punës të shërbimit civil në organizatën buxhetore Komuna e Klinës, në këtë përbërje:
 - Xhavit Dauti, kryesues;**
 - Ajet Sejdiu, anëtar;**
 - Driton Raci, anëtar.**
- Grupi punues si nga pika 1 e këtij vendimi punën e vete e kryen bazuar në Ligjin për Zyrtaret Publik, nr.06/L-114, Rregulloren e (QRK) nr.10/2022 për Klasifikimin e vendeve të Punës në Shërbimin Civil, duke u bazuar edhe në kërkesat e dala nga shkresa e MPB, nr.1959 e datës 14.12.2022.
- Grupi punues punët i kryen në koordinim më Drejtorinë e Administratës dhe për punën e vet i përgjigjet kryetarit të komunës, i cili njoftohet lidhur më propozimin e klasifikimit të vendeve të punës të shërbyesve civil dhe për veprimet e nevojshme procedurale.
- Ky vendim është i plotfuqishëm dhe hynë në fuqi menjëherë.

Te njoftohen:

- Te përmendurit;
- Ministria e Punëve të Brendshme;
- Ekzekutivi;
- Zyra e informimit, si dhe;
- Arkivi.

Kryetari,
Zenun Elezaj

